



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA PËR ZHVILLIMET NË TERRITOR

Nr. 3567/2 Prot.

Datë 23.05.2025

Lënda: Dërgohet **Vendimi Nr. 11, datë 28.01.2025** "Për Miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës për objektin: "Ndërtimi i linjës 110kv Gjiri i Lalëzit – Fush Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110kv Fush Kuqe", me zhvillues "Operatorin e Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a.

ARKIVIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

KRYEMINISTRIA

ARKIVIT QENDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT

TIRANË

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

TIRANË

OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT (OST) SH.A.

Adresa: Yrshek, autostrada Tirane-Durres, km 9

TIRANË

Të nderuar,

Në mbledhjen e datës **28.01.2025**, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit ka miratuar **Vendimin Nr. 11**, "Për Miratimin e Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës për objektin: "Ndërtimi i linjës 110kv Gjiri i Lalëzit – Fush Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110kv Fush Kuqe", me zhvillues "Operatorin e Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., në përputhje me Ligjin Nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Lidhur me sa më sipër, Ju lutem gjeni bashkëngjitur kopjet origjinale të:

- **Vendimit të sipërcituar**, të sigluar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e Sekretarit të KKTU-së.
- **Hartës së Planvendosjes së Strukturave** (pjesë përbërëse e vendimit në fjalë), të sigluar nga Kryetari i KKTU-së dhe Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo informacion të nevojshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Adelajda Roka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 11, datë 28.01.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJE NDËRTIMI INFRASTRUKTURE PËR OBJEKTIN:
“NDËRTIMI I LINJËS 110 kV GJIRI I LALËZIT- FUSH KUQE DHE SHTESA E
NËNSTACIONIT 110 kV FUSH KUQE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKITË KURBIN,
DURRËS DHE KRUIJË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Operatorit të Sistemit të Trasmetimit sh.a (OST), Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Leje Ndërtimi Infrastruktura për objektin: “Ndërtimi i Linjës 110 kV Gjiri i Lalëzit - Fush Kuqe dhe shtesa e nënstacionit 110 kV Fush Kuqe”, me vendndodhje në Bashkitë Kurbin, Durrës dhe Krujë, me zhvillues Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kurbin, Durrës dhe Krujë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga kryetari, ministri i linjës dhe sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 21 / 05 / 2025

